



In medias res

Etapat e zhvillimit të kurrikulit

“Mësimdhënësit nuk i zbatojnë kurrikulat dhe u qasen programeve mësimore alternative për shkak të politikave konfuzë dhe joreale të kurrikulave të zyrtarëve “
Stenhouse, 1975

Ekspertët kurrikular kanë qasje të ndryshme për etapat e zhvillimit të kurrikulit. Për këtë është mirë të konsultohet vepra: “Kurrikulat, bazat, parimet dhe problemet” të autorëve amerikan, Orstein, A.C. & Hunkins, P.F. e botuar edhe në gjuhën shqipe, nga instituti i Studimeve Pedagogjike në Tiranë në vitin 2003. Me gjithë mendimet e ndryshme pjesa dërmuese e ekspertëve veçojnë këto katër etapa:

- Etapa përgatitore- preparative
- Etapa e hartimit - krijimit të kurrikulit,
- Etapa zbatimit të kurrikulit
- Etapa e monitorimit dhe e vlerësimit të efikasitetit dhe të efektivitet të Kurrikulit të zbatuar

Këto etapat mund të programohen me efektivitet të lartë duke përdorë njëri nga edhe metodat e Planifikimit Rrjetor. Në fig.1 është paraqitur një diagram rrjetor i etapave të zhvillimit të Kurrikulave sipas Metodës së Rrugës Kritike (Critical Path Methode)




Fig. 1. Etapat e zhvillimit të Kurrikulit - Metoda e rrugës Kritike

Diagrami i paraqitur rrjetor operacionalizohet në rrjete dhe nënrrjete duke e bërë analizën e strukturës, analizën kohore, dhe analizën e shpenzimeve-kostos. Natyrisht se përdorimi i metodave të planifikimit rrjetor kërkon aftësimin e hartuesve të planit për zbatimin këtyre metodave. Shpenzimet të cilat do të bëhen për aftësimin e ekspertëve për përdorimin e metodave të planifikimit rrjetor, do të ulin shumë shpenzimet për zhvillimin e kurrikulave, por edhe do të ndikojnë në avancim të jashtëzakonshëm të cilësisë së hartimit të kurrikulave dhe të lidhjeve korelative ndërmjet etapave të zhvillimit të cilat do të marrin formën spitalore.

Etapa përgatitore-preparative - Kjo etapë paraqet themelin në procesin e zhvillimit të kurrikulave: "...secili ndryshim në kurrikul ndodh si përgjigje në nevojat e hetuara dhe të identifikuar, përkatësisht në mosbalancim e gjendje ekzistues dhe të gjendjes të cilën e dëshirojmë [...] Në këtë fazë bëhet analiza e nevojave përkatësisht mbledhja dhe grumbullimi i informacioneve për atë se çka nxënësit, prindërit, mësimdhënësit profesionistët, punëdhënësit, politikanët dhe faktorët e tjerë mendojnë se është e nevojshme se duhet të ndryshojë, të futet si gjë e re ose të mënjanohet-largohet nga sistemi, Petrić, Branka, 2006"

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Programi i granteve për zhvillimin e shkollave

■ Gjatë muajit tetor ka vazhduar themelimi i Ekipeve Komunale të Granteve Shkollore (EKGSh). Deri në fund të muajit janë themeluar pothuajse të gjitha EKGSh, me përjashtim të komunës së Prishtinës, Graçanicës, Parteshit dhe rajonit të Mitrovicës veriore. Me qëllim që të shpejtojë procesin e themelimit të EKGSh-ve në komunat me shumicë serbe, KEC ka përkthyer udhëzimin administrativ për themelimin e EKGSh në gjuhën serbe. Pritet që EKGSh në këto komuna të themelohen gjatë pjesës së parë të muajit nëntor. Me themelimin e EKGSh, hapet mundësia për përzgjedhjen e shkollave të cilat do të përfitojnë grante.

■ Në këtë muaj janë mbajtur dhe mbledhjet e EKGSh në 8 komuna si: në Mitrovicë, Skenderaj, Kacanik, Hani i Elezit, Shtime, Ferizaj dhe Pejë, në të cilat janë propozuar shkollat që mund të përfitojnë grantet shkollore. Në komunat e tjera ky proces do të përfundojë në pjesën e parë të muajit nëntor. Lista e shkollave të propozuara sipas komunave do të dorëzohet në MASHT, për aprovim nga Këshilli për aprovimin e granteve shkollore (KAGSh).

KOSOVISION Contest

■ Mësimdhënësit dhe nxënësit e klasave të pesta gjatë këtij muaji kanë realizuar me sukses orët e punës në kuadër të projektit dhe tani janë në fazën përfundimtare të posterit (pllakatit) dhe idesë së projekteve të cilat ata do të realizojnë pas shpalljes së fituesve që bëhet në muajin dhjetor. Gjatë muajit

tetor një numër i madh i klasave të pesta është monitoruar. Tanimë të gjithë e kanë të qartë projektin dhe secila shkollë mundohet të jep maksimumin në mënyrë që të sjellin fitore për klasat dhe shkollat e tyre.




■ Po ashtu gjatë këtij muaji janë bërë edhe përgatitjet e para rreth organizimit të vlerësimit të punimeve i cili do të bëhet gjatë muajit nëntor. Në të gjitha regjionet e Kosovës, është bërë edhe përzgjedhja e anëtarëve të komisionit për vlerësim. Secili regjion do të ketë 3-5 anëtarë të komisionit.



Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të projektit "Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit", financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, gjatë këtij muaji është publikuar Raporti i parë i

hulumtimit. Ky raport do të iu shpërndahet të gjitha palëve me interes si dhe të gjitha shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim.



- Pasi që janë bërë përgatitjet për monitorimin e tretë, duke përfshirë këtu përgatitjen e pyetësorëve dhe takimet me monitoruesit, ka filluar monitorimi i tretë në shkollat e synuara dhe shkollat e grupit kontroll.

- Gjatë muajit tetor është mbajtur edhe takimi i katërt drejtues i projektit ku janë diskutuar të arriturat e projektit gjatë kësaj periudhe dhe aktivitetet të cilat duhet të realizohen deri në fund të projektit.

- Në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti janë duke u bërë përgatitjet e para për organizimin e ciklit të dytë të trajnimeve me fëmijë në kuadër të projektit.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

- Në kuadër të këtij projekti gjatë muajit tetor janë organizuar këto aktivitete:

- U botua libri me praktikat më të mira të përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së grupeve pakicë në jetën e shkollës nga shtetet partnere. Libri përmban nga 3 praktika më të mira të mbledhura nga organizatat partnere në 5 shtete, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë dhe Serbi.

- Në Kroaci prej 24-28 tetor u mbajt punëtorja për hartimin e strategjisë për bashkëpunimin në mes të organizatave partnere në projekt. Në punëtori morën pjesë nga tre përfaqësues të organizatave partnere.



Gjatë punëtorisë u hartua strategjia për bashkëpunim i cili do të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit. Pjesë marrja ishte shumë aktive dhe të gjithë kontribuan në hartimin e strategjisë. Drafti i parë i strategjisë do të jetë gati më 15 nëntor.

Qasja Tërësektoriale në Arsim – EU EDUCATION SWAp

- Projekti Qasja Tërësektoriale në Arsim - EU EDUCATION SWAp ka filluar të implementohet në muajin tetor të vitit të kaluar. Ky projekt financohet nga Komisioni Evropian dhe menaxhohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO).

Projekti implementohet nga konsorciumi i përbërë nga Cambridge Education, Qendra

për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm.

■ Gjatë muajit Tetor ky projekt së bashku me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka organizuar një varg punëtorish me grupet punuese për hartimin e kurrikulumit të ri të Kosovës duke filluar nga punëtorja informuese e mbajtur me 6 tetor 2010, për të vazhduar me punëtorinë dy ditore të 12 e 13 tetorit dhe një punëtori përmbyllëse me 20 tetor.



Gjithashtu mes punëtorisë së 12 e 13 tetorit dhe asaj të 20 tetorit secili grup punues ka punuar vazhdimisht nën udhëheqjen e Koordinatorit/ës dhe zëvendës koordinatorit/ës së grupit dhe me mbështetje të një eksperti ndërkombëtar e një eksperti vendor.



Qëllimi i këtij aktiviteti ishte: Ngritja e Kapaciteteve Institucionale të MASHT-it

(d.m.th. Ekipit Teknik, Njesisë Teknike për Zhvillim të Kurrikulumit, Këshillit Shtetëror/Agjencisë për Zhvillim të Kurrikulave dhe Grupeve Punuese për Zhvillim të Kurrikulumit),

Ky aktivitet ka rezultuar me hartimin e rezultateve mësimore thelbësore për gjashtë fushat mësimore për secilën nga gjashtë shkallët e kurrikulumit.

Kurrikuli i Edukimit multi/ndër/kulturor

Gjatë muajit tetor është organizuar diskutimi publik i Kornizës së Kurrikulit të Edukimit Multi/ndër/kulturor të hartuar në kuadër të këtij projekti.

Në takimin e Grupit të Punës është vendos që në kuadër të përmbylljes kurrikulare të shtohet edhe një fushë e veçantë që lidhet me arsimin afornal, përkatësisht me Rolin e Mediave në përhapjen e Edukimit multi/ndër/kulturor. Janë shtuar tetë njësi mësimore.

Pas diskutimit publik Korniza e Kurrikulit të Edukimit multi/ndër/kulturor është bartur ne ueb faqen e KEC dhe të ARrK.

Mbështetje e BE-së për Zbatimin e Strategjisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptas (EU-SIMRAES)

■ Gjatë këtij muaji, Projekti EU-SIMRAES ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me 6 qendrat e komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian, si dhe me OJQ-të partnere që implementojnë komponentin e arsimit.

Gjatë këtyre takimeve të mbajtura në këto qendra, janë identifikuar nevojat për pajisje dhe inventar, janë mbledhur të dhënat statistikore për secilin qendër (edhe pse nuk paraqesin të dhëna shumë të

besueshme), si dhe janë bërë fotografi në secilën qendër me qëllim të analizimit më të thellë për nevojat reale të tyre.

EU-SIMRAES ka bërë një përshkrim të secilës qendër duke përfshirë të dhëna të detajuara si statistikën e komunitetit, hapësira e punës, komunitetet që frekuentojnë këtë qendër, aktivitetet të cilat janë duke i ndërmarrë dhe ato që i planifikojnë në të ardhmen etj.

■ Komponenti i Arsimit i implementuar nga KEC, gjatë kësaj periudhe në detaje i ka hartuar planet për implementimin e programeve në vijim:

- Programin parashkollor (moshat 3-6)
- Programin shkrim-lexim
- Programin e ofrimit të pakove shkollore (moshat 6-15)
- Programi për ndihmë të detyrave të shtëpisë (moshat 6-15)
- Programin e aktiviteteve rinore (kjo është dhënë si përmbledhje shkaku se OJQ-të partnere pritet t'i organizojnë këto aktivitete)
- Programin e bursave

■ Projekti EU-SIMRAES është duke bashkëpunuar ngushtë me OJQ-të dhe agjencitë tjera partnere që i ndihmojnë komunitetet rom, shkallë dhe egjiptian. Duhet të përmendet takimi koordinues i mbajtur në Mitrovicë më 13 Tetor me MercyCorps, Caritas, DRC, UNICEF etj, që kishte për qëllim njoftimin me programet e projekteve dhe gjetjen e mënyrë të koordinimit të aktiviteteve.

■ Gjatë muajit nëntor planifikohet të punohet në dizajnimin e programeve për secilën qendër dhe në bashkëpunim me OJQ-të partnere do të zhvillohen dhe hartohen planet njëvjeçare për punën që do të zhvillohet sipas planit të Hartuar në Raportin Nismëtar.

■ Në fund, vlen të përmendet se Raporti Nismëtar që përfshin pjesën e KEC, respektivisht komponentin e arsimit është hartuar hollësisht dhe i njëjti është dërguar tek Autoriteti Kontraktues (KFOS) dhe me rastin e kompletimit të komponentit tjetër Mediave dhe Kulturës do të dërgohet në ZNKE për miratim.

Përgatiti: Petrit Tahiri